Zyrtari për IT ka kryer te gjitha shërbimet e Komunës së Shtimes në fushën e IT-së, duke dhënë përkrahja teknike dhe profesionale për zyrtarët e administratës komunale dhe sistemin e teknologjisë në përgjithësi, duke përfshire: Administrimi i shërbimeve LAN/EAN, instalimi dhe konfigurimi i sistemeve operative, programeve aplikative, instalimi dhe konfigurimi i kompjuterëve për operim funksional në rrjetë, instalimi dhe konfigurimi i printerëve, fotokopjeve, skanerëve, përkrahjen teknike të nivelit dytësor për Helpdesk-un, monitorimi dhe publikimi online i mbledhjeve të Kuvendit Komunal etj.

Sektori i Shërbimeve Teknike
Ka kryer këto shërbime: Sigurimi dhe mirëmbajtja e objekteve të Komunës, menaxhimin me stafin teknik, mirëmbajtja e pajisjeve në sallën e Kuvendit të Komunës, mirëmbajtja e ngrohjes qendrore, kryerja e punëve teknike rreth regjistrimit dhe mirëmbajtjes së

shërbime, dalje nga depoja aseteve, paisjeve teknike dhe teknologjike etj. Gjatë kësaj kohe është bërë edhe inventarizimi i aseteve dhe vendosja e barkodeve dhe regjistrim i gjitha paisjeve në sistem për zyret e drejtorëve dhe zyrtarët e ri në administratë.

Në periudhen Janar-Qershor 2024, nga ana e Zyrtarit për Depo janë kryer këto lëndë:

| | |
|---|---|
| Fatura të pranuara | 123 Fatura |
| Dalje nga depoja mallra e shërbime | 74 Dalje |
| Ngarkime,transfere,dhe shkarkime të mallrave | 287 Dalje |
| Fatura te procesuara per free balance | 219fatura |
| Kerkesa per ngritje te procedurave | 6 Kerkesa |
| Kerkesa per pagesa te faturave Kerkesa | 69 |
| Regjistrimi i veturave | 3 Vetura |

Përgjegjesi i Auto Parkut: Ka menaxhuar këto shërbime: Me kërkesat për shfrytëzimin e veturave, është kujdesur dhe ka mbajtur evidencat për punët teknike të veturave si: kilometrat e kaluar, karburantet e shpenzuara si dhe servisim dhe mirëmbajtjen e të gjitha automjeteve. Kërkesat drejtuar përgjegjësit të autoparkut janë si në vijim:

| | |
|---|---|
| Kërkesa për fletë dalje me veutra | 472 Kërkesa |
| Raporte si menaxher kontrate | 42 Raporte |
| Kërkesa për dokumente nga arkiva | 36 Dokumente |
| Kilometra të kaluara: | |
| Pasat 05Z-11-22 | 6430 km |
| Golf V 05Z-04-22 | 7232 km |
| Golf V 05Z-06-22 | 5103 km |
| Toyota 05Z-07-22 | 2408 km |
| Toyota 05Z-09-22 | 1530 km |

Drejtoria Komunale e Arsimit

Në këtë raport janë pasqyruar të gjitha aktivitetet, punët dhe angazhimet e Drejtorisë Komunale për Arsim, nga 1 janari, deri në fund të muajit qershor 2024.

Në të gjitha shkollat e komunës sonë, më 24 janar ka filluar procesi mësimor në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2023/2024.

Pjesëmarrja e nxënësve në Garat Komunale dhe Republikane

Më 13 shkurt 2024, në shkollën fillore "Emin Duraku" në Shtime është organizuar nga DKA, Gara Komunale e Fizikanëve të Rinj. Pjesëmarrës në këtë garë kanë qenë fituesit e garave shkollore të të gjitha shkollave të komunës sonë nga klasat 9, 10, 11 dhe 12. Nga kjo garë, nxënësit fitues komunën e Shtimes e kanë përfaqësuar në Olimpiadën Kosovare në Fizikë, 2024, të mbajtur më 9 mars 2024, në Departamentin e Fizikës në Prishtinë.
Më 25 prill 2024, Kryqi i Kuq i Kosovës - Dega në Shtime ka mbajtur garat në nivel komunal për dhënien e Ndihmës së Parë me nxënësit e të dy shkollave të Mesme të Larta, Gjimnazin "Naim Frashëri" dhe IAAP në Shtime.

Më 8 maj 2024 u mbajt Kuizi i Diturisë "Ekonomia 2024", ku pjesëmarrës ishin këto institucione shkollore: IAAP "Ymer Prizreni" nga Prizreni, SHME "Hasan Prishtina" nga Mitrovica, SHMLP "Selajdin Mullabazi-Mici" nga Rahoveci, IAAP "Abdyl Ramaj" nga Shiroka (Suharekë), SHMLP "Bahri Haxha" nga Vushtrria dhe Qendra e Kompetencës nga Prizreni. Në vitin e kaluar, nxënës nga Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional nga Komuna e Shtimes ishin fitues, prandaj këtë vit Shtimja ishte nikoqire për organizimin e kësaj gare. Shkollat të cilat fituan në këtë garë të diturisë ishin:

Vendi i Parë: SHME "Hasan Prishtina" - Mitrovicë,
Vendi i Dytë: Qenda e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" - Malishevë,
Vendi i Tretë: "Abdyl Ramaj" - Suharekë.

Me nxënësit e klasave të pesta, më 1 mars 2024 në ShMU "Emin Duraku" është mbajtur Gara e Diturisë, kurse për nder të Ditës së Mësuesit, më 7 Mars është mbajtur finalja ku vendin e parë e kanë zënë nxënësit e ShFMU "Lasgush Poradeci" nga Muzeqina. Ky aktivitet është realizuar nga OJQ "Link" në bashkëpunim me DKA-në.

Në vazhdën e aktiviteteve për shënimin e 12 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Komunës së Shtimes, në ambientet e Shtëpisë së Kulturës, u bë ndarja e shpërblimeve dhe mirënjohjeve për nxënësit fitues në Garën Komunale të Diturisë, të shkollave të Komunës së Shtimes. Në Garën Komunale të Diturisë, të mbajtur më 25 maj dhe 6 qershor të këtij viti, dijen e tyre e kanë sfiduar gjithsej 230 nxënës të të gjitha shkollave të mesme të ulëta të komunës sonë, prej të cilëve 135 nxënës janë fitues të vendeve të para, dyta dhe treta.
Testit të diturisë, i janë nënshtruar nxënësit e klasës së gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë. Testi në fjalë është zhvilluar në nëntë lëndë mësimore: Gjuhë shqipe, gjuhë angleze, gjeografi, histori, matematikë, biologji, fizikë, kimi dhe teknologji informative.
Për shkollën që zuri vendin e parë në këto gara, Drejtoria e Arsimit ka dhënë një llaptop, ndërsa për shkollat që zunë vendin e dytë nga një tablet elektronik, kurse për shkollën fituese të vendit të tretë një komplet me libra.
Garat Komunale të Diturisë janë organizuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe OJQ "Pronet Academy" në objektin e Shkollës Fillore "Emin Duraku" në Shtime, ku janë shënuar

1. ShFMU "Emin Duraku" – Shtime, Vendi i Parë,
2. ShFMU "Lasgush Poradeci" – Muzeqinë, Vendi i Dytë,
3. ShFMU "Bajram Curri" – Petrovë, Vendi i Dytë,
4. ShFMU "Abdullah Shabani" – Carralevë, Vendi i Tretë.

Bursa për studentë

Më 16 prill 2024, Drejtoria Komunale e Arsimit ka shpallur Konkurs për Ndarjen e Bursave për studentë të Komunës së Shtimes për vitin akademik 2023/2024. Afati i aplikimit ka qenë 15 ditë (2 maj). Në vitin paraprak janë ndarë 70 bursa për studentë, ndërsa sivjet është rritur numri i tyre dhe do të ndahen 100 bursa për studentë. Shtimi i numrit të studentëve që do të marrin bursë, do të jetë një mbështetje e fuqishme dhe motiv shtesë, për studentët e dalluar që ta shtojnë përkushtimin e tyre në drejtimet e studimeve që ndjekin. Bursat do të ndahen për 10 (dhjetë) muaj dhe shuma mujore e tyre është 50 euro për student, gjegjësisht 500 euro për një vit. Deri në mbyllje të konkursit kanë aplikuar gjithsej 203 studentë. Aktualisht është duke punuar komisioni prej pesë anëtarëve në përzgjedhjen e sudentëve duke u bazuar në kriteret e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për studentë.

Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë (I) për vitin shkollor 2024/2025

Sipas Planit Dinamik të Punës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime, ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë të arsimit fillor për vitin shkollor 2024/2025. Me këtë rast, DKA në bashkëpunim me shkollat e komunës së Shtimes nga data 15 maj – 15 qershor 2024 ka bërë regjistrimin e tyre në klasën e parë.
Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) nr. 09-2023, në klasat e para të shkollave fillore të Komunës së Shtimes është bërë regjistrimi i fëmijëve, të cilët kanë mbushur moshën minimale 6-vjeçare. Numri i paraleleve të planifikuara për regjistrim të nxënësve në klasën e parë të arsimit fillor është 22 paralele, ku deri më tash janë regjistruar gjithsej: 332 filloristë, gjë që krahasuar me vitin paraprak kemi 26 nxënës më pak të regjistruar.

Organizime tjera në kuadër të institucioneve arsimore

Me rastin e 16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës është shënuar 17 Shkurti në të githa institucionet e arsimit me aktivitete të ndryshme.
Për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës së Shtimes është shënuar me aktivitete të ndryshme kjo ngjarje me rëndësi kulturore dhe historike. Gjatë kësaj dite, ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, në Bibliotekën Kombëtare në Prishtinë ka dhënë mirënjohje për mësimdhënësit e dalluar, në mesin e të cilëve nga komuna e Shtimes është shpërblyer Besim Buja, arsimtar i biologjisë në SHFMU "Lasgush Poradeci" në Muzeqinë
Ndërkaq, në sallën e Asamblesë Komunale në Shtime, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) ka organizuar një ceremoni festive kushtuar 7 Marsit – Ditës së Mësuesit. Me këtë rast, DKA ka dhënë mirënjohje për mësimdhënësit e dalluar, mirënjohje post-morem për mësimdhënsit e ndjerë dhe mirënjohje për veteranët e arsimit.
Me rastin e 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Drejtoria Komunale e Arsimit për të gjitha punojnëset e institucioneve edukativo-arsimore të komunës së Shtimes ka dhuruar lule.

mbjellur lule e drunj dekorativ nëpër oborre të shkollave.
Drejtoria Komunale e Arsimit së bashku me grupin punus ka përgatitur Draft-Planin e Veprimit kunder braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në shkolla, i cili në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Shtimes, të mbajtur më 29. 4. 2024 është miratuar pas diskutimit publik.
Më 17 maj 2024 për të gjithë nxënësit e klasave të para të komunës së Shtimes është organizuar shënimi i Festës së Abetares, me një program të pasur kulturo-artistik të gërshetuar me këngë, valle e recitime. Në shënimin e Festës së Abetares morën pjesë mësues, prindër, nxënës e të tjerë.
Më 7 maj 2024, në Shkollën e Mesme të Ulët "Emin Duraku" të Shtimes nga Klubi i Gjelbër i kësaj shkolle është organizuar aktiviteti tashmë tradicional "Sofra Shkollore, 2024". Tryeza shkollore ishte mbushur përplot me ushqime të llojllojshme, të përgatitur nga nxënësit e kësaj shkolle dhe prindërit e tyre. Ky aktivitet shkollor që organizohet për nëntë vite me radhë ka për qëllim sigurimin e një fondi për zhvillimin e aktiviteteve shkollore. Gjatë këtij aktiviteti, nxënësit e shkollës kanë shfaqur një program të pasur kulturo-artistik të gërshëtuar me këngë, valle e recitime.
Për nder të 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve në institucionet tona arsimore janë organizuar aktivitete të ndryshme për fëmijë. Me këtë rast, në Institucionin Parashkollor "Albiona Asllani" në Shtime janë shpërndarë dhurata simbolike për të gjithë grup-moshat e fëmijëve të çerdhës. Po ashtu, me rastin e kësaj dite nga DKA janë shpërndarë dhurata edhe për të gjithë fëmijët e klasave përgatitore. Në të gjitha inistitucionet shkollore, fëmijët kanë zhvilluar aktivitete sportive, muzikë, ngjyrosje, lojëra edukative e të tjerë.
Me rastin e 25 vjetorit të çlirimit të komunës së Shtimes, të gjitha institucionet arsimore kanë organizuar një varg aktivitetesh në kujtim të ditës historike të 12 Qershorit.

Aktivitete sportive
DKA në bashkëpunim me Federatën e Sportit Shkollor të Republikës së Kosovës, kanë përzgjedhur nxënësit e ShFMU "Abdullah Shabani" dhe SHFMU "Lasgush Poradeci" për aktivitetin sportiv shkollor dimëror "Drejt Malit". Ky aktivitet është realizuar në Brezovicë, ku nxnënsit e klasës së shtatë për një javë kanë mësuar skijimin dhe rregullat e këtij sporti dimëror. Gjithashtu kanë bërë aktivitete të shumta me lojëra të ndryshme, ku ishin prezent edhe shumë shkolla të tjera të Kosovës.
Në kuadër të garave shkollore, më 24 prill 2024 u mbajtën garat komunale në futsall, për shkollat e mesme të larta të Komunës së Shtimes. Këto gara u organizuan nga SHPKF dhe Sporti Shkollor në bashkpunim me DKA-në dhe DKRS-në. Në garat në futsall triumfoi ekipi nga IAAP.

Mbrëmja e Maturës, 2024
Më 18 maj 2024 është organizuar Mbrëmja e Maturës për 340 nxënës të Gjimnazit "Naim Frashëri" (210) dhe të Institucionit të arsimit dhe Aftësimit Profesional (130), e cila është mbajtur në restorantin "BA - Place" në Davidovc. Këtë aktivitet e kanë organizuar drejtoritë e dy shkollave të lartshënuara. Për mbarëvajtjen dhe sigurinë u përkujdes gjatë gjithë kohës, Policia e Kosovës, me një organizim të shkëlqyeshëm. Nxënësit kanë kaluar këtë natë të hareshme me një atmosferë të mrekullueshme dhe pa asnjë ekces.

Shëtitjet njëditore nga nxënësit e klasave të nënta

Në fund të muajit maj dhe në fillim të muajit qershor 2024, për nxënësit e shtatë shkollave të mesme të ulëta, respektivisht për nxënësit e klasave të nënta është organizuar shëtitje njëditore nëpër territorin e Republikës së Kosovës. Zakonisht gjatë këtyre shëtitjeve,

të Rusolisë nga gurra e shpellës së Radavcit (Pejë), në 586 metra lartësi mbidetare, i cili përndryshe njihet si lumi më i madh i gjeografisë shqiptare. Vizitohet Prekazi legjendar prej ku ka nisur liria e Kosovës, Shpella e Mermertë e Gadimes, një nga vlerat më të bukura dhe më të rralla speleologjike në Evropë, vizitohen shpatijet e Sharrit siç është Prevalla dhe Brezovica piktoreske, mandej Ujëvara e Mirushës në fshatin Llapçevë (Malishevë), Burimi i Istogut me rrjedhje prej 2,500 litra ujë në sekondë, i cili buron në lartësi mbidetare 480 metra si dhe vendbanime tjera turistike.

Organizimi i Piknikut për Nxënës Filloristë (I-V)

Për nxënësit e shkollave fillore (I - V), realizohet pikniku dy herë në vit, në fillim të vitit shkollor dhe në përfundim të vitit shkollor. Dita e Piknikut është ditë mësimi dhe organizohet brenda territorit të komunës së Shtimes, zakonisht në fshatin Llanisht. Meqenëse territori i komunës sonë është i vogël, me miratim paraprak të prindërve të nxënësve janë lejuar të vizitojnë Parkun Nacional "Gërmia" në Prishtinë, fshatin piktoresk të Jezercit (Ferizaj) dhe vende tjera.

Shënimi i Ditëve të Shkollave

Për çdo vit, shkollat e komunës së Shtimes, shënojnë ditat e tyre të shkollave. Programi i tyre ka përmbajtur pjesë të zgjedhura artistike dhe profesionale, të cilin e kanë përgatitur mësimdhënësit dhe nxënësit. Ditat e shkollave në këtë vit shkollor janë shënuar më:

20 Maj – Dita e SHFMU "Lasgush Poradeci" në Muzeqinë;
27 Maj – Dita e Gjimnazit "Naim Frashëri" në Shtime;
29 Maj – Dita e SHFMU "Idriz Ajeti" në Pjetërshticë;
30 Maj – Dita e SHFMU "Bajram Curri" në Petrovë;
10 Qershor – Dita e SHFMU "Emin Duraku" në Shtime;
11 Qershor – Dita e SHFMU "Skënderbeu" në Reçak;
12 Qershor – Dita e SHFMU "Abdullah Shabani" në Carralevë.
13

Java e Dyerve të Hapura në IAAP dhe Gjimnaz

Drejtoria e Arsimit, në bashkërendim me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta dhe MASHTI-n, në funksion të orientimit në karrierë dhe informimit të nxënësve të klasave të nënta (IX), me drejtimet (profilet) e shkollave të mesme të larta, nga data 22 – 26. 4. 2024 kanë organizuar aktivitetin "Java e dyerve të hapura".
Për një informim sa më të detajuar, shkollat e mesme të larta, nxënësit vizitor i kanë njoftuar përmes informatave, si: Pankarta, prezantime mbi sukseset dhe rezultatet e shkollës, stafin e mësimdhënësve, kushtet brenda shkollës, ku nxënësit zhvillojnë praktikën profesionale, profilet që ofrojnë këto shkolla dhe mundësitë e inkuadrimit në tregun e punës pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale. Pra, e gjithë kjo ka reflektuar pozitivisht, sepse nxënësit janë të mirë-informuar për mundësitë që ofrojnë këto shkolla në zhvillimin e tyre profesional dhe mundësitë për punësim pas përfundimit të shkollimit në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) në Shtime.

Java e Informimit në Gjimnaze për Orientim në Karrierë

Për orientim në karrierë janë zhvilluar një sërë aktivitetesh nga 22 – 26 prill 2024, të cilat janë përcaktuar për të ndihmuar nxënësit e klasave të XII-ta të zgjedhin drejtimet e tyre në arsimin e lartë. Ky aktivitet ka pasur për qëllim që nxënësit gjatë këtyre ditëve të marrin sa më shumë informata rreth mundësive ekzistuese për orientim në karrierë në Republikën e

e tyre profesional, vazhdimin e studimeve dhe punësimit të tyre pas përfundimit të arsimit të lartë. MASHTI ka siguruar materialet shtesë për organizimin e këtij aktiviteti duke përgatitur pankarta me mundësitë dhe informatat shtesë për orientim në karrierë.

Ceremonia e Diplomimit të Maturantëve

Më 14 qershor 2024, në ambientet e Shtëpisë së Kulturës në Shtime është mbajtur Ceremonia e Diplomimit të gjeneratës së maturantëve 2023/2024. Përmes kësaj ceremonie festive është shënuar përfundimi i një kapitulli të rëndësishëm dhe fillimi i një udhëtimi të ri për maturantët tanë që kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë në Gjimnazin "Naim Frashëri".

Investime të rëndësishme

Në vazhdën e digjitalizimit të institucioneve arsimore në Kosovë, më 26 prill 2024 në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Shtime, u bë lansimi i internetit të qëndrueshëm dhe të kontrolluar "Shkolla e 100-të".
Ky investim ka për qëllim digjitalizimin dhe modernizimin e infrastrukturës telekomunikuese në institucionet arsimore të komunës sonë dhe në nivel vendi. Me këtë projekt janë të mbuluara shpenzimet e internetit për pesë vite.
Projekti Kosovo Digital Economy (KODE) i Ministrisë së Ekonomisë, ka sjellë përfitime të mëdha në Komunën tonë, duke siguruar një lidhje të qëndrueshme të internetit në shtatë objekte shkollore. Ky investim ndër të tjera ofron edhe mundësi të barabarta për nxënësit tanë, për të përmirësuar aftësitë e tyre që po njihen e dëshmohen gjithnjë e më shumë, si në nivelin vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar në fushën e teknologjisë. Përmes këtij projekti është bërë instalimi i rrjetit të internetit në këto institucione arsimore:

1. ShMU "Emin Duraku"-Shtime,
2. ShFMU "Lasgush Poradeci"-Muzeqinë,
3. ShFMU "Hasan Prishtina"-Godanc,
4. ShFMU "Skënderbeu"-Reçak,
5. ShFMU "Bajram Curri"-Petrovë,
6. Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional-Shtime,
7. Gjimnazi "Naim Frashëri"-Shtime.

Më 19 qershor 2024 është përuruar Observatori dhe Planetariumi i parë Kombëtar i Kosovës (OPKK) në fshatin Rashincë, i cili ka kushtuar mbi 300 mijë euro. Puna më pak se dy vjeçare dhe bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Komunës së Shtimes, Organizatës "Astronomy Outreach of Kosovo" e përmes tyre me kompaninë e prodhimit të teleskopëve, Celestron, kompanisë Sky-Ëatcher USA dhe organizatës amerikane Sunlit Earth!/The Charlie Bates Solar Astronomy Project, tash do t'i ofrojë të gjithëve mundësinë për të vrojtuar gjithësinë.
Observatori dhe Planetariumi do të ofrojnë mundësi të shkëlqyera për edukimin shkencor dhe eksplorimin e hapësirës qiellore duke dhënë mundësi për shtim të diturisë për nxënësit, studentët dhe të gjithë entuziastët e astronomisë.
Gjithashtu, Komuna jonë përmes këtij projekti do të shndërrohet në një atraksion shkencor turistik ku do të merr vëmendje të gjerë ndërkombëtare për hulumtime astronomike, falë edhe faktit se këtu ndodhet edhe teleskopi më i madh për vrojtim në Evropën Lindore, që përfundimisht na vendos në hartën e lokacioneve me rëndësi strategjike për kërkime shkencore astronomike.

Divizioni për Standarde, Vlerësim dhe Monitorim që vepron në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në bashkëpunim me DKA-në bëjnë organizimin e përvitshëm të vlerësimit të jashtëm të nxënësve.

Më 30-31 maj 2024, në Gjimnazin "Naim Frashëri" dhe Shkollën e Mesme të Ulët "Emin Duraku" në Shtime është realizuar vlerësimi ndërkombëtar TIMSS (Studim Ndërkombëtar i Prirjeve në Matematikë dhe Shkencë), të cilit i janë nënshtruar gjithsej 93 nxënës të klasave të pesta (V) nga këto shkolla: ShF "Emin Duraku" në Shtime (41 nxënës), ShFMU "Lasgush Poradeci" Muzeqinë (26 nxënës) dhe ShFMU "Idriz Ajeti" në Pjetërshticë (26 nxënës). Ky test ka besueshmëri të lartë dhe ka ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e politikave arsimore të vendeve që marrin pjesë.

Më 22 qershor 2024 do të organizohet Provimi Shtetëror i Maturës për vitin 2024, ku në komunën tonë këtij testi do t'i nënshtrohen gjithsej 291 nxënës maturantë. Testi në fjalë, do të organizohet në tri qendra mësimore: Në IAAP (75), në Gjimnazin "Naim Frashëri" (216) dhe në ShMU "Emin Duraku" në Shtime.

Më 25 qershor dhe 28 qershor 2024 do të mbahet Testi i Arritshmërisë, ku pjesa e parë përmban pyetjet nga lëndët shoqërore, ndërsa pjesa e dytë ka pyetje për lëndët shkencore.

Më 25 qershor do të mbahet pjesa e pare e testimit e cila përmban njohuri nga gjuha amtare, gjuha angleze, historia dhe gjeografia.

Ndërkaq, më 28 qeshor do të mbahet testimi i njohurive për lëndën e matematikës, informatikës, kimisë, fizikës dhe biologjisë.

Kjo mënyrë e organizimit të testimit ishte praktikuar edhe vitin e kaluar, me ç'rast nxënësit u testuan në dy data të ndryshme për lëndë të ndryshme.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

15 JANARI 2024 – "DITËT PËRKUJTIMORE TË MASAKRËS SË REÇAKUT"

Në këtë vit, për nderë të 15 Janarit, janë organizuar "Ditët Përkujtimore të Masakrës së Reçakut". Aktivitetet janë mbajtur nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës Sh.T.Z Albin Kurti, në përkujtim dhe nderim të kësaj dite, duke filluar nga data 13 janar.

13.1.2024

- Është shfaqur shfaqja teatrale "Shkamat" me regji të profesor Fadil Hysaj
- Është mbajtur koncert me këngë korale nga AKV"Ilirida"

14.1.2024

- Në përkujtim të kësaj dite është mbajtur një aktivitet nga SHBA"Guri i Shtrenjtë"- Ecja tradicionale për nder të 25 Vjetorit të Masakrës së Reçakut
- Është mbajtur Ora e Madhe Letrare

15.1.2024

- Në Kompleksin Memorial në Reçak u bënë homazhe nga krerët e shtetit dhe nga qytetarë të shumtë, nga e gjithë Kosova.
- Është mbajtur Orë Përkujtimore kushtuar 25-Vjetorit të Masakrës së Reçakut. Të pranishëm në këtë ngjarje ishin përfaqësues të Institucioneve qëndrore lokale si dhe ish ambasadori amerikan z.Ëilliam Ëalker.

19 JANAR 2024 –

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës, z. Qemajl Aliu së bashku me shoqatat e dalura nga lufta e UÇK-së është mbajtur manifestimi përkujtimor me rastin e 25 vjetorit të rënies së Heroit të Kombit, Ahmet Kaçiku dhe dëshmorëve të lirisë, të rënë në Reçak, më 15 janar 1999.

- Janë bërë homazhe në Varreza e Dëshmorëve si dhe te varri i heroit të kombit Ahmet Kaçiku,
- Në Shtëpinë e Kulturës, në Shtime, u mbajt edhe një Akademi përkujtimore për t'i nderuar të rënët për liri.

26 JANAR 2024 – është shpallur konkursi për aplikim për sportistët më të dalluar të vitit 2023.

13 dhe 14 SHKURT 2024

- Është realizuar shfaqja teatrale për fëmijë "Super Air"me regji të Behar Ibishit dhe të shkruar nga Ergjan Mehmeti

14 SHKURT 2024

- Për nderë të 15 Shkurtit – Ditës së Flamurit të Komunitetit Ashkali, Këshilli Organizativ i komunitetit ashkali në bashkëpunim me Komunën e Shtimes, ka organizuar program kulturor-artistik, i cili është përkrahur nga DKRS.

17 SHKURTI 2023 – 16 VJETORI I PAVARËSISË SË KOSOVËS

Përvjetori i Pavarsisë së Kosovës është shënuar me aktivitete të ndryshme të organizuara në bashkëpunim me klubet sportive, OJQ lokale dhe shkollat.

i Arsimit dhe Aftësimit Profesional ( në Shkollën Profesionale)

- Është zhvilluar ndeshja miqësore në volejboll nga KVF"Vjosa" dhe KVF"Malisheva" ( në Palestrën e Sporteve në Shtime);

17.2.2024

- Është mbajtur Seanca Solemne e Kuvendit të Komunës së Shtimes;
- Janë bërë homazhe te shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, homazhe në Varrezat e Dëshmorëve në Shtime, Carralevë, Rancë, Reçak dhe Mollopolc;
- Inagurimi i Kullës, në Mollopoc;
- Është mbajtur Ceremonia e zgjedhjes së sportistëve të vitit 2023 (në Shtëpinë e Kulturës);
- Shfaqja e baletit nga shkolla e baletit "Let's Dance"nga Prishtina;
- Programi kulturo-artsistik nga Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Ilirida" (në Shtëpinë e Kulturës).

5.3.2024

- Është mbajtur shfaqja për fëmijë "KËSULKUQJA", me regji të Sabri Pajazitit.

ËSHTË SHËNUAR 26-VJETORI I EPOPESË SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

5 MARS 2024 –

- Është mbajtur mbledhje solemne e Kuvendit të Komunës së Shtimes, kushtuar Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

6 MARS 2024

- Në shenjë nderimi për luftën dhe sacrificën për liri, gjatë ditës delagacioni nga Komuna, ka bërë homazhe edhe në Kompleksin Momerial "Adem Jashari", në Prekaz
- Janë bërë homazhe pranë shtatores së Komondantit Legjendar Adem Jashari, në qendër të Shtimes, pastaj te Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së, në Shtime, në Kompleksin Memorial në Reçak dhe te Varrezat e Dëshmorëve në Mollopolc.

10 MARS 2024

- Është mbajtur turniri tradicional i shahut për nder të Epopesë së UÇK-së

7 MARS 2024

- Është realizuar shfaqja, "LIBRI MAGJIK", me autor Dashuri Rexhepi.

8 PRILL 2024

- Është shënuar dita e komunitetit Rom, aktivitetet janë përkrahur nga DKRS.

12 PRILL 2024

- Në Shtëpinë e Kulturë,s në Shtime, është promovuar libri "Idriz Daut Rexhepi dhe bashkëveprimtarët e tij", nga autori Halil Halili.

20 PRILL 2024

- Është zhvilluar gara tradicionale e peshkimit me tapë, e organizuar nga Shoqata "Salmoni" në kategoritë e seniorëve, juniorëve, pionerëve dhe vajzave.

23 PRILL 2024

- Është shënuar me aktivitete të ndryshme Dita Botërore e Librit, me vizita në shkolla , biblioteka dhe bashkëbisedim me nxënësit rreth kësaj dite.

- Është mbajt turniri në Volejboll me nxënëset (femra) e Shkollave të Mesme të Ulëta dhe Shkollave të Mesme të Larta, në kuadër të projektit: "Masovizimi i volejbollit tek femrat e Komunës së Shtimes", përkrahur nga DKRS, M4Y dhe MAPL.

7 MAJ 2024
- Është shfaqur Premiera e Dramës " Enea i Plagosur", me regji të Iliriana Arifit.

10 MAJ 2024
- Është promovuar Libri "Melodité e Zemrës" nga Aurela Dugolli.

Më datë 23.5.2024, do të shfaqet premiera e shfaqjes "Çka je ti", nga Klubi teatral i Shtimes dhe "Art Polis", me mbështetje të Frieda dhe Komunës së Shtimes.

Më datë 30.5.2024, do të shfaqet premiera e shfaqjes " Pacienti i doktor Frojdit".

Më datë 30.5.2023, është shfaqur premiera e shfaqjes "N'VJENË" me regji të Astrit Bytyqit".

Më datë 01.6.2023
- Aktivitet rekreativ me fëmijët e vendosur në strehim familjarë ( në bashkëpunim me Organizatën për fëmijët pa përkujdesje prindërore.
- Lojëra, argëtim, vizatime, muzikë dhe maskota në sheshin " Ahmet Shtimja".
- Shfaqje teatrale për fëmijë " Libri Magjik" me regji të Dashuri Rexhepit.

Më datë 06.6.2023

Ansambli i Këngëve dhe Valleve "ILIRIDA" si përfitues i projektit Komuna për të Rinjët, shpalosi projektin "Edukimi i të rinjve në Instrumente muzikore" projekt ky i cili u mundësua nga Qeveria Japoneze në partneritet me CDF-në, Municipalities for Youth dhe Komuna Shtime.

NËN PATRONATIN E KRYETARIT TË KOMUNËS SË SHTIMES, z.QEMAJL ALIU DHE SHOQATAVE TE DALURA NGA LUFTA, KOMUNA E SHTIMES-DREJTORIA PËR KULTURE,RINI DHE SPORT PËR NDER TE 25 VJETORIT TE DITËS SË CLIRIMIT, KA ORGANIZUAR KËTO AKTIVITETE:

Më datë 10.6.2023
- Lojë miqësore në Futboll nga Klubet e futbollit të vajzave nga qyteti i Shtimes dhe Prishtinës vendi, Palestra e Qytetit.
- Shfaqje teatrale e realizuar nga Kryqi i Kuq – Dega në Shtime ( në Shtëpinë e Kulturës).
- Defilim me motocikleta nga Klubi i Veteranëve të UQK-së
- Koncert festiv me këngëtarin Asim Gashi ( Sheshi Ahmet Shtimja)

Me datë 11.6.2023
- Shfaqje teatrale " Enea i Plagosur" me regji të Iliriana Arifit ( Shtëpia e Kulturës)
- Ekspozitë nga nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Shtimes (Shtëpia e Kulturës).
- Koncert festiv nga Ansambli i këngëve dhe valleve " ILIRIDA" ( Shtëpia e Kulturës)

- Homazhe dhe vendosja e kurorave dhe buqetave me lule te Shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, duke vazhduar te varrezat e deshmorëve të UQK-së në Shtime, Mollopolc, Recak,Rance dhe Carralevë.
- Ecja tradicionale e bjeshkatarëve të SHBA " Vjosa"
- Takimi i kryetarit të komunës me familjarët e dëshmorëve të komunës së Shtimes.
- Ndarja e mirënjohjeve për nxënësit, të cilët kanë marrë pjesë në garat e diturisë të shkollave fillore të Komunës së Shtimes ( Shtëpia e Kulturës)

Më datë 15.6.2023

- Shfaqet premiera e baletit "SPRING" Koreografia e kësaj shfaqje ishte nga Vlora Prizren dhe Sead Vuniqi.Kjo premierë u bë e mundur falë bashkëpunimit të Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport në Shtime dhe Shkollës së Baletit "Angels". ( Vendi : Shtëpia e Kulturës)

Sport

Të gjitha klubet sportive kan përfunduar garat e sezonit pranveror dhe kan arritur rezultate të kënaqshme:

Klubi i Futbollit "Vjosa" garon në Ligë e Parë "B" të Futbollit në Republiken e Kosovës dhe janë në vendin e tretë në tabelë, me grupmoshat e fatosëve janë kampion në grupin "A" të regjionit të Ferizajit dhe me grupmoshat e Kadetëve Kampion, në regjionin e Ferizajit.

Klubi i Futsallit " Vjosa" garon në Superligën e Kosovës në Futsall, kanë përfunduar garat e sezonit pranveror dhe janë në vendin e katërt në tabelë.

Klubi i Hendbollit "Vjosa" femrat – kanë përfunduar garat në sezonin pranveror dhe radhiten në vendin e dytë në ligën e parë të hendbollit të Kosovës, ndërsa vazhdojnë garat me grupmoshat e pioniereve.

Klubi i Hendbollit " Vjosa" meshkujt - kanë përfunduar garat në sezonin pranveror dhe tani kanë kaluar në Superligën e Kosovës në Hendboll.

Klubi i Volejbollit " Vjosa" femrat –nuk i kanë zhvillu garat në sezonin pranveror në ligën e parë të voljebollit të Kosovës, garat do t'i vazhdojnë në sezonin vjeshtor.

Klubi i Volejbollit " Vjosa" meshkujt– kanë përfunduar garat në sezonin pranveror në ligën e parë të voljebollit të Kosovës dhe radhiten në vendin e katërt në tabelë.

Klubi i Veteranëve të Futbollit "Vjosa"- kanë përfunduar garat në Ligën e Veteranëve në Futboll.

Klubi i Çiklizmit "Vjosa" –klubi i Çiklizmit „Vjosa" nga Shtimja (nukoqirë i garës), në bashkëpunim me Federatën e Çiklizmit të Kosovës kanë organizuar garën çiklistike rrugore "Road Race In Memoriam 'Nusret Msliu'" , të dytë me radhë të kalendarit të garave për edicionin garues 2024

Klubi i Motocrossit "Vjosa" – ka realizuar garën në kuadër të Federatës të Motocrossit në Kosovës, ku pjesmarrës kanë qenë 45 garues nga e gjithë Kosova dhe nga Maqedonia e Veriut.

Klubi i Kik-Boksit "Skender Salihaj" – kanë zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të kalendarit të Fedeartës së Kik-Boksit të Kosovës, kanë marr pjesë në kampionatin botëror në Turqi, ku kikboksieret e tanë e kanë përfaqësuar Kosovën në këtë kampionat.

Klubi i Boksit "Skender Salihaj"- kanë zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të kalendarit të Fedeartës së Boksit të Kosovës, kanë marrë pjesë në turne të ndryshëm në Kosovë.

Klubi i Karatesë "Vjosa"- kanë zhvilluar garat në kuadër të Federatës së Karates të Kosovës.

SHBA"Guri i Shtrejntë" -ka zhvilluar disa aktivitete të bjeshkatarisë, ecje me rastin e datave me rëndësi në komunën e Shtimes.

SHBA"Vjosa"- kan realizuar disa aktivitete të bjeshkatarisë gjatë kësaj periudhe.

SUBVENCIONET

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjatë kësaj periudhe, ka bër dy thirrje publike për përkrahje financiare për OJQ-të rinore, kulturore dhe klubet sportive.
Thirrja për sport ka vlerën prej 61,000.00€ dhe ka përfunduar, kanë përfituar 15 klube sportive dhe shoqata sportive-rekreative.
Thirrja për Kulturë dhe për Rini ka vlerën prej 23,000.00€ dhe është e hapur nga data 17.5.2024 deri më 6.6.2023.

MUZEU I QYTETIT

Gjatë periudhës Janar- Maj, Muzeun e Qytetit e kanë vizituar (319) vizitorë ku (166) prej tyre kanë qenë meshkuj dhe (153) prej tyre femra, po ashtu në mënyrë të organizuar kanë vizituar muzeun, gazetarë, studentë të historisë, nxënës të shkollave, të cilët kanë parë për së afërmi reliktet dhe eksponatet që janë në muze dhe kanë mësuar për historinë dhe vlerat e muzeut, pastaj ka pasur vizita edhe nga OJQ-ët dhe televizonet e ndryshme, institucionet etj.

BIBLIOTEKA E QYTETIT

Në Bibliotekën e qytetit vazhdimisht po rritet numri i lexuesve dhe fondi i librave, numri total i lexuesve gjatë periudhës Janar-Maj është 640, lexues aktivë 250, lexues të rinj janë 22, libra të lexuara janë 400, libra të dhuruara gjithsej janë 15 nga qytetarët e Shtimes dhe libra jasht përdorimit janë 6
Biblioteka jonë posedon një numër të madh të librave të fushave të ndryshme për studim po ashtu edhe vetëm për lexim në kohën e lirë.

INVESTIMET KAPITALE

Projektet kapitale që janë të planifikuara në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, për vitin 2024 e që kan përfunduar me procedurat e prokurimit dhe që janë lidhur kontratat, dhe priten të fillojnë punimet shumë shpejt sipas planit të menaxhimit janë:
Projekti për Zërimin dhe Ndriçimin Profesional në Shtëpinë e Kulturës-projek në vlerë prej 24,292.00 €, ka përfunduar sipas planifikimit.
Projekti, Ndërtimi i fushës sportive në fshatin Zborc, projekt dyvjeçar, i cili ka vlerën 39,444.74€ dhe përfundon në muajin gusht të këtij viti.
Projekti Rrethojat e fushave sportive në fshatin Carralevë, Petrovë dhe Davidoc, ky projekt është dyvjeçar dhe përfundon në këtë vit dhe ka vlerën totale 59,168.63€
Projekti Renovimi i Shtëpisë së Kulturës, është në procedurë të hartimit të projektit nga kompania projektuese.
Projekti Konservimi i Eksponatave të Muzeut të Qytetit, gjithashtu është në procedurë të hartimit nga kompania projektuese.

PROJEKTET PËR FURNIZIME DHE SHËRBIME, disa janë ende në procedurë të prokurimit dhe disa kanë përfunduar dhe janë lidhur kontratat si:
Furnizimi me buqeta lulesh, e cila ka vleren prej 1,430.00€
Furnizim i zyres nga DKRS, kemi vlerën prej 769.51€
Furnizimi me material higjienik nga DKRS, kemi vleren prej 1,130.80€
Furnizimi me llaptop dhe kompjuter nga DKRS,kemi vlerën 540.00€

PROJEKTET E PËRKRAHURA NGA MINISTRIA E KULTURËS , RINISË DHE SPORTIT

Projekti, Punët ndërtimore për zbatimin e hollësishëm të arkitekturës dhe inxhinierisë për zgjerimin dhe renovimin e Stadiumit të Qytetit, ky projekt është dyvjeçar dhe ka filluar të realizohet dhe ka vlerën 2,424,242.42€.

Projekti Renovimi i Palestresd se qytetit me date 19.6.2024 ka filluar punimet ku ky projekt kap vleren mbi 400 mije euro dhe punimet priten te zgjasin diku rreth 15 muaj.

Projektet, Invertarizimi i Bibliotekës së Qytetit dhe Restaurimi dhe Renovimi i Shtëpisë së Përshpirtshmë janë në fazën e tenderimit në MKRS.

## Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Planifikimi vjetor i veprimtarisë së Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për vitin 2024 bazohet në prioritetet zhvillimore të Komunës së Shtimes dhe kompetencat e drejtorisë në fushën strategjike të Zhvillimit Ekonomik

Në bazë të planit të punës së Drejtorisë, kemi paraparë që gjatë këtij viti të bëhet monitorimi i aktiviteteve dhe investimeve në Parkun Teknologjik, si dhe për bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Planifikohet gjithashtu zbatimi i procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale dhe bashkëpunimi me institucione qeveritare dhe joqeveritare për të mbështetur Zhvillimin Ekonomik.

Vazhdimi i punimeve në Parkun Teknologjik gjatë këtij viti dhe asfaltimi i të gjithë rrugëve brenda parkut, si dhe sigurimi i kushteve të mira për bizneset që operojnë në atë zonë, janë pjesë e agjendës sonë.

Në Zonën Ekonomike Gllavicë jemi në pritje të hartimit të PZHK-SE për marrjen e aprovimin e fundit nga Ministria e Bujqësisë për konvertimin e tokës bujqësore në tokë për ndërtim për biznese që do të operojnë në atë zonë Ekonomike.

Po investojmë gjithashtu 100,000 euro nga Buxheti komunal për infrastrukturën brenda Zonës Ekonomike dhe presim mbështetje nga MINT për Zonën Ekonomike.

Gjatë këtij viti kemi planifikuar Investime Kapitale për rregullimin e kanaleve kulluese të ujrave atmosferike në tokat bujqësore, si dhe rregullimin e shtigjeve profesionale për ciklizëm dhe MotoCross në Zonat turistike Mullopolc Llanisht.

Punimet vazhdojnë në rregullimin e rrugës Idriz Seferi dhe në rregullimin e parkut të pishat në Shtime, faza IV.

Investimet kapitale përfshijnë gjithashtu hapat e rëndësishëm për ngrohjen e qytetit me biomasë, ku kemi përfunduar fizibilitetin e zgjeruar së bashku me CNVP-në dhe ekspertët austriakë.

Këtë vit jemi në përfundim të procedurave për rrugët me zhavor të fshatrave Mullopolc, Vojnoc, Recak, Petrovë, Gjyrkovc, Godanc, Muzeqinë, Rashincë dhe Pjetershticë, si dhe për shenjëzimin e pikave turistike në zonat kodrinomalore të komunës sonë dhe kanalizimin në zonën e biznesit në komunën e Shtimes.

Po kërkojmë aprovimin për renovimin e infrastrukturës në Parkun Teknologjik në vlerë prej 300,000 euro.

Gjatë vitit 2024, planifikojmë të hapim një thirrje për subvencionimin e bizneseve të vogla dhe të mesme, duke ofruar ndihmë për bizneset ekzistuese dhe startup-e.

## Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi

### Njësia për Urbanizëm

| Nr | Objektivi/detyra e punës | Aktiviteti |
|---|---|---|
| 1 | Drejton dhe mbikëqyr punët në kuadër të sektorit | 1.1 Propozon masa preventive që rregullojnë lëminë e urbanizmit |
| | | 1.2 Menaxhon çështjet komplekse në kuadër të sektorit |
| | | 1.3 Interpreton ligjet, Udhëzimet dhe zbatimin e drejtë të tyre |
| 2 | Përgjigjet për lëshimin e lejeve ndërtimore | 2.1 Lëshon sqarime për kushte urbanistike |
| | | 2.2 Kontrollon projektin në detaje dhe cakton taksat |
| | | 2.3 Lëshon leje ndërtimore |
| 3 | Mbikëqyrja e projekteve në terren | 3.1 Mbikëqyrja e projekteve gjatë realizimit të tyre |
| | | 3.2 Raporti i punës së përfunduar në terren |
| | | 3.3 Kontrollimi i ditarit dhe librit të punës |
| 4 | Mbushja e aplikacioneve për fonde të ndryshme | 4.1 Aplikimi për grante në BE |
| | | 4.2 Dhënie e informacioneve per marrjen e fondeve |
| | | 4.3 Ndimon në procesin e hartimit të planit të qytetit |
| 5 | Punët e tjera në kuadër të sektorit | 5.1 Punët për pranime teknike në kuadër të drejtorisë |
| | | 5.2 Implemetimi i strategjive zhvillimore të komunës |
| | | 5.3 Mbajtja e evidencës i të hyrave në sektor |

### Njësia për Ndërtim

| Nr | Objektivi/detyra e punës | Aktiviteti |
|---|---|---|
| 1 | Drejton dhe mbikëqyr punët në kuadër të sektorit | 1.1 Propozon masa preventive që rregullojnë lëminë e ndërimtarisë |
| | | 1.2 Menaxhon çështjet komplekse në kuadër të sektorit |
| | | 1.3 Zbaton ligjet në mënyrë të drejtë |
| 2 | Mbikëqyrja e projekteve në terren | 2.1 Ndihmon në hartimin e planit të qytetit |
| | | 2.2 Ndihmon dhe përcjell dinamikën e punëve në terren |
| | | 2.3 Kontrrollimi i ditarit dhe librit ndërtimor |
| 3 | Hartimi i projekteve në kuadër të sektorit | 3.1 Ndihmon në hartimin dhe implementimin e strategjive zhillimore |
| | | 3.2 Punon në përgatitjen e projekteve dhe përcjell realizimin e tyre |

| | | |
|---|---|---|
| 4 | Mbushja e aplikacioneve për fonde të ndryshme | 4.1 Ofron informatat profesionale në procesin e vendimmarrjes<br>4.2 Tregon kreativitet per projektet me donatorë |

Në këto projekte është punuar në periudhën janar-qershor,

Pagesa të ekzukutuara në këtë periudhë janë: 758,019.75 ose 54% në Drejtorinë e Urbanizmit nga buxheti Komunal

Projektet në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës:
1.Asfaltimi i shtresës së parë në rrugën "14.dhjetori"
2.Asaltimi i rrugës "17 shkurti"
3.Hapja dhe asfaltimi i një pjese në rrugën Godanc-Zborc-Pjetërshticë
4.Fillimi i rehabilitimit të rrugëve "Ëilliam Voker"dhe disa rrugë të tjera
5.Nënshkrimi i kontratës se rrugës "Mehdi Korani" Petrovë
6.Rehabilitimi i rrugës Davidovc-Rashincë-Muzeqinë
7.Rruga te Parku i Biznesit në Gllavicë

1. Asfaltimi i rrugës dhe rregullimi i ndricimit publik dhe trotuarit në Shtime: rr. 12 Qershori, 14 Dhjetori, Tahir Sinani, Adem Jashari, Renovimi i sheshit Ahmet Shtimja, Rregullimi i kanalizimit në Shtime në rrugën "Ëillian Voker"
2. Asfaltimi i rrugëve dhe trotuareve dhe rregullimi i ndricimit ne Godanc, rruga 17 Shkurti, segmenti i rrugës "Topilla" segmenti i rrugës "Muhaxheria" rruga "Q. Mikullovci"
3. Rregullimi i poligonit per ciklizëm te Parku i Pishave
4. Asfaltimi i rrugëve dhe trotuarve ne Davidoc rr "I.Rugova" rruga - segmenti "Smajl Gorani" segmenti "Emini", "Baftiu", ndricimi i rrugës "Sadriu", "Zeq Zeqiri"
5. Ndertimi i urave ne Petrove, Carralve, Muzeqine (rruga "Haxhi Halimi") dhe Recak
6. Rregullimi i trotuareve dhe asfaltimi i rrugëve në Mollopolc rr. Sopa, rruga – segmenti Islam Neziraj, trotuar ne zonen e nerodimes, trotuar nga salla - qeshmja ne Mollopolc
7. Asfaltimi i rrugeve dhe rregullimi i ndricimit publik ne Petrovë: rruga "Nazmi Bakiu" rruga "Xhemshir Xhemshiri" rruga "Mehdi Korani" segmenti "Kruja"
8. Rregullimi i rrugëve dhe kanalizimit ne Godanc rruga "Shtegu UÇK-se" rruga "Sopiani" segmenti i rrugës "Dëshmorët e Godancit" rruga "Marigona" segmenti i rruges "Arsim Zeqiri" segmenti i rrugës "Vëllezërit Hyseni"
9. Asfaltimi i disa segmenteve te rrugeve dhe rregullimi i ndricimit dhe kanalizimit ne fshatin Pjetreshtice, rruga "Aziz Dugolli" rruga "Rrezja", ndricimi ne rrugën "I. Ajeti", rruga

10. Asfalltimi i rrugëve, ndricimit dhe trotuarit në Gjurkoc segmenti i rrugës "Bushati", ndricimi në rr. "Pjetërshtica", rruga "Kasirati"

11. Asfaltimi i rrugeve, rregullimi i trotuareve dhe kanalizimit ne lagje te Pajtimit ne segmentin "Sh.Muhadini" segmentin e rrugës "Çameria" rruga "Besim Ndreca" asfaltimi I rrugës tek varrezat

12. Rregullimi i rrugeve dhe ndricimit ne Carralve ne rrugen "Balaj, segmenti i rrugës "Ali Tafa" rruga te varrezat e Carraleves

13. Rregullimi i rrugeve, ndricimit dhe kanalizimi ne Zborc rruga "Hafir Bajrami" dhe ne rr "Rifat Haliti"

14. Asfaltimi i rrugës së varrezave në fshatin Dugë dhe hapja e rrugës te kodra e Bretencit

15. Asfaltim i rrugeve, trotuareve dhe ndricimit ne Rashince rruga "Cani" rruga Burimi" rruga "Ferizajit" rruga "Beqir Rushiti" rruga "Trimat e Lirise", rruga "Qorrolli"

16. Asfaltimi i rrugës në fshatin Rancë segmenti i rrugës "Martirët Asllani"

17. Asfaltimi i rrugeve dhe rregullimi i ndricimit ne Gllavice segmenti "Galica", segmenti "Ferati"

18. Asfaltimi i rrugeve dhe rregullim i ndricimit ne Vojnoc segmenti rruga "jashari" rruga"Ulqini", rruga "Mehmeti" rruga "Bashkim Emini"

19. Asfaltimi i rrugeve dhe shtrimi i trotuareve në Muzeqinë segmenti i rrugës "V.Halimi", segmenti i rrugës "M.Hoxha" rregullim i knalizimit ne rrugën "Fehmi Agani" rruga "Rushiti"

20. Rregullimi i murit mbrojtës në Recak afer Kompleksit dhe asfaltimi i rrugës "15janari", rrugës "pavarsia" kanalzimi ne rrugën "D. Recakut"

21. Ndertimi i unazes se Qytetiti - Pagesat për shpronesime mbi 190 mije euro jane paguar te Unaza e Qytetit

22. Asfaltimi i rrugës "Skenderbeu" segmenti i rrugës "Afrim Musliu" dhe rruga "Emrushi"

Nga muaji mars sektori i infrastrukturës fillon punen me hartimin e projeteve kapitale sipas sipas buxhetit te Komunes dhe buxhetit te Qeverisë.

1.Ndërtimi i Komunes.
2.Rruga Luzhak-Rance.
3.Rregullimi i shtratit te "Lumit Shtimjanja"
4.Unaza që lidh 12 Qershorin me "Ëilliam Voker"
5.Rruga Pjetershticë-Dugë.

## Drejtoria e Shërbimeve Publike

Përshkrimi i detyrave

Zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me ofrimin e kushteve optimale për popullatën në lëmin e shërbimeve publike, nëpërmjet ndërmarrjeve publike dhe institucioneve tjera që menaxhojnë dhe kujdesen për ofrimin e këtyre shërbimeve;
Furnizim me ujë të pijes;
Menaxhimin e sistemit të kanalizimit;
Menaxhimin e mbeturinave;
Menaxhimin e investimeve kapitale në infrastrukturën publike;
Pastrimin, larjen dhe largimin e borës dhe akullit nga rrugët dhe trotuaret;
Sigurimin e mirëmbajtjes së parqeve, hapësirave publike dhe varrezave;
Funksionimin e tregjeve;
Ofrimin e shërbimeve lokale dhe të infrastrukturës duke përfshirë ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe transportin lokal;
Kujdesin për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta;
Planifikimin e nevojave shpenzuese dhe investuese të Drejtorisë.
Aktivitetet
